

GrCF2W2 - Transporti Urban Prishtinë II

Lokacioni: Kosovë

Projekti numër: 51923

Spektori i biznesit: Infrastruktura komunale dhe mjedisore

Lloji i njoftimit: Shteti

Kategoria mjedisore: B

Data e aprovimit: 06 dhjetor 2022

Statusi: **Aprovuar**

DPP i shpalosur: 07 dhjetor 2022

Sipas seksionit 1.4.2 (iii) të Direktivës për Qasjen në Informacion: "Për projektet e miratuara nga menaxhmenti i Bankës ku Bordi i Drejtorëve ka deleguar autoritetin për aprovim, DPP do të shpaloset në fillim të periudhës përkatëse të njoftimit për asnjë kundërshtim për një vend anëtar të Bankës në përputhje me nenin 13 (iii) të Marrëveshjes për Themelimin e BERZH-it."

Përshkrimi i projektit

Blerja e 30 autobusëve të rinj, ku përfshihen 24 autobusë Euro VI dhe 6 autobusë elektrikë me bateri dhe infrastrukturë përkatëse për mbushje, të cilët do t'i shtohen flotës ekzistuese të autobusëve të Trafikut Urban ("Klienti" ose "Kompania"), për të zgjeruar operacionet e veta ("Projekti"). Projekti do t'i mundësojë Kompanisë të rrisë shpeshësinë e shërbimeve të autobusëve dhe të shtojë linja të reja nëpër Komunën e Prishtinës ("Qyteti"). 6 autobusë elektrikë do të vendosen në një itinerar pilot me synimin për ta futur teknologjinë e autobusëve elektrikë për herë të parë në vend.

Objektivat e Projektit

Objekti i projektit është shtimi i shërbimeve dhe përmirësimi i besueshmërisë, qëndrueshmërinë, sigurisë dhe efikasitetit të transportit publik të Prishtinës. Projekti pritet të sjellë përfitimet e mëposhtme:

- Zgjerimi dhe përmirësimi i shërbimeve të transportit publik në qytetin e Prishtinës;
- Mbështetja e kalimit të vazhdueshëm nga makinat private në transportin publik;
- Lehtësimi i qasjes së lehtë për pasagjerët, veçanërisht ata me lëvizje të kufizuara, duke përfshirë të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara;
- Përmirësimi i besueshmërisë, sigurisë dhe efikasitetit të transportit publik;
- Ulja e emetimeve të ndotjes së ajrit nga transporti publik, duke përmirësuar cilësinë e ajrit lokal; dhe

- Ulja e gazrave serë përmes lansimit të një linje pilot me autobus elektrik.

Futja e një linje me autobusi elektrik është një hap i rëndësishëm drejt zhvillimit të një sistemi të qëndrueshëm të transportit urban. Strategjitë për elektrifikim të flotës zakonisht fillojnë me një numër fillestar të kufizuar automjesh të alokuara në linja të veçanta autobusësh për qëllime operacionale dhe demonstruese. Kjo lejon njohjen me teknologjinë dhe mirëmbajtjen dhe kufizon risqet e blerjes së flotës së plotë ndërkohë që teknologjia zhvillohet me shpejtësi. E njëjta strategji konsiderohet të jetë e përshtatshme për Prishtinën, ku operatori synon të prezantojë teknologjinë e autobusëve elektrikë për herë të parë në vend, duke blerë 6 automjete elektrike që do të shërbejnë për një linjë kryesore qarkore që kalon përmes qendrës së qytetit të Prishtinës. Ky pilot do të përdoret për të fituar përvojë në funksionimin e autobusëve elektrikë publikë dhe do të lehtësojë kalimin e vazhdueshëm të flotës drejt autobusëve elektrikë në të ardhmen.

Futja e autobusëve elektrikë dhe autobusëve EURO VI do t'i reduktojë për 76% emetimet e GS-ve krahasuar me nivelin bazë dhe do të sjellë ulje të konsiderueshme të emetimeve të ndotësve të ajrit, duke e bërë Projektin të pranueshëm për Qytetet e Gjellbra të BERZH-it dhe kompatibël me Qasjen e Tranzicionit të Ekonomisë së Gjellbër 2021-2025 (BDS20-082/F).

Ndikimi i Tranzicionit

Rezultatet e ETI: 70

Korniza për Qytetet e Gjellbra II ("GrCF2") përfaqëson një qasje strategjike dhe me shumë projekte që synon të ndihmojë në identifikimin dhe adresimin e sfidave mjedisore në qytetet e mëdha të përzgjedhura në vendet tona të operimit. Qëllimi parësor është arritja e përmirësimeve të rëndësishme mjedisore dhe promovimi i cilësisë së tranzicionit të **gjellbër** në qytetet përkatëse. Përveç objektivit mjedisor, GrCF2 promovon edhe qytete të qëndrueshme përmes zhvillimit urban gjithëpërfshirës, rezilient, të menaxhuar mirë dhe të mençur. Në varësi të asaj se cila zonë mund të gjenerojë ndikimin më të fortë dhe më të rëndësishëm të tranzicionit, si cilësi dytësore e tranzicionit për secilin nën-projekt sipas kornizës do të ndiqet dhe do të paraqitet Qeverisja e mirë, Gjithëpërfshirja, Rezilienca ose Konkurrues. Këto objektiva të tranzicionit mbështeten nga zhvillimi dhe zbatimi i një Plani Veprimi për Qytet të Gjellbër ("PVQGJ") specifik për qytetin, që synon të identifikojë sfidat mjedisore, të lehtësojë koordinimin dhe pranimin më të mirë midis palëve të interesit dhe të ndihmojë në përcaktimin e prioritetëve dhe zhvillimin e mënyrave më të mira për të adresuar sfidat mjedisore nëpërmjet investimeve të targetuara, shërbimeve dhe instrumenteve të politikave. PVQGJ-ja ka një qasje gjithëpërfshirëse, duke përfshirë edhe konsiderimin e barazisë gjinore në qytet.

Projekti bazohet në arritjet e projektit të parë të Bankës me Kompaninë, me të cilin për herë të parë në Kosovë u prezantua një Kontratë e Shërbimit Publik ("KSHP").

Projekti do të promovojë kryesisht cilësinë e tranzicionit të **gjelbër** duke përmirësuar ndikimet mjedisore të sistemit të transportit urban në Prishtinë dhe do të rezultojë në ulje për 76% të emetimeve të GS-ve krahasuar me nivelin bazë. Kjo do të arrihet përmes futjes në përdorim të autobusëve elektrikë në linjën qendrore të qytetit për herë të parë në vend, zgjerimit të flotës së qytetit me autobusë të përputhshëm me standardet EURO VI diesel dhe përfundimisht përmes zhvendosjes modale të përdoruesve nga minibusët ekzistues me ndotje të lartë dhe makinat, drejt shërbimeve të autobusëve të rinj, duke qenë se transporti përbën një nga ndotësit kryesorë në qytet.

Projekti gjithashtu do të promovojë cilësinë e tranzicionit të **qeverisur mirë** duke mbështetur reformën sektoriale të transportit publik të Prishtinës përmes mbështetjes me BT pas nënshkrimit, të ofruar si pjesë e Projektit. BT-ja do ta mbështesë Komunën për rristurimin e rrjetit të autobusëve sipas rekomandimeve nga Plani i saj për Lëvizshmëri të Qëndrueshme Urbane, duke përfshirë: (i) futjen e një rrjeti të integruar të autobusëve dhe sistemit të biletave (p.sh. tarifave, oraret etj.); (ii) një sistem të përmirësuar kontraktues të shërbimit të autobusëve; dhe (iii) në qytet do të krijohet një njësi monitoruese e dedikuar për KSHP-në.

Projekti është gjithashtu me **shtesa gjinore** pasi: i) do të përfshijë konsiderata për të promovuar barazinë gjinore në shërbimet e transportit publik në një detyrë të BT pas nënshkrimit, dhe ii) Projekti do të përfshijë një shqyrtim të politikave për BNJ të Kompanisë për të promovuar mundësi të barabarta si pjesë e Planit për Veprim Mjedisor dhe Social të Klientit.

Informata për Klientin

NDËRMARRJA PUBLIKE KOMUNALE TRAFIKU URBAN

Klienti është Trafiku Urban, një ndërmarrje publike e transportit urban me autobus 100% në pronësi të Komunës së Prishtinës.

Përmbledhja e Financimit të BERZH-it

10,000,000.00 EURO

Gjithsej Kosto të Projektit

10,764,580.00 EURO

Shtesë

Projekti është një transaksion i përsëritur me Kompaninë, megjithatë struktura e projektit ndryshon nga transaksioni i mëparshëm duke prezantuar një strukturë jo sovranë me një KSHP dhe një angazhim të drejtpërdrejtë me Komunën për t'i çuar më tej përpjekjet për reformën e sektorit të transportit publik në nivel të qytetit.

Burimet shtesë të Bankës janë:

Struktura e Financimit: BERZH ofron një afat, i cili është mbi mesataren e tregut dhe është i nevojshëm për strukturimin e projektit.

Zbutja e Riskut: Marrëdhënia afatgjatë e BERZH-it me një klient i ofron komfort klientit për të qenë i gatshëm të marrë përsipër më shumë risk dhe/ose financim, duke mundësuar rezultate të tilla si inovacioni ose zgjerimi në tregje të reja (futja e autobusëve elektrikë).

Vendosja e standardit:

- Klienti kërkon/përdor ekspertizën e BERZH-it për përmirësimet e qeverisjes së korporatës, duke përfshirë menaxhimin dhe planifikimin e riskut të klimës përmes PVQGJ-së.
- Klienti kërkon/përdor ekspertizën e BERZH-it për standarde më të larta mjedisore sesa 'biznesi si zakonisht'
- Klienti kërkon/përdor ekspertizën e BERZH-it për miratimin e standardeve gjinore dhe planeve të veprimit për mundësi të barabarta

Përmbledhja Mjedisore dhe Sociale

Kategorizuar B (Politika Mjedisore dhe Sociale 2019 ("PMS")). Kujdesi i Duhur Mjedisor dhe Social ("KDMS") u krye nga një konsulent i pavarur dhe përfshiu një vizitë në terren dhe shqyrtimin e statusit të zbatimit të Planit për Veprim Mjedisor dhe Social ("PVMS") në lidhje me projektin e parë për autobusë me Kompaninë. U identifikuan risqet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale ("MS") që lidhen me blerjen e 30 autobusëve shtesë (24 autobusë Euro VI dhe 6 autobusë elektrikë) dhe infrastrukturës përkatëse për mbushje, dhe do të menaxhohen përmes zbatimit të një PVMS-je të rishikuar. Monitorimi për MS në transaksionin e parë tregon në përgjithësi një progres të mirë në zbatimin e PVMS-së fillestare. PVMS-ja fillestare është rishikuar për të pasqyruar gjetjet e KDMS-së dhe është dakorduar me Kompaninë.

Kompania ka vendosur disa masa të menaxhimit mjedisor dhe social dhe është e angazhuar për t'i përmbushur kërkesat kombëtare. Punimet e rinovimit në bazën e autobusëve (financuar nga transaksioni fillestar) përfunduan në vitin 2019, duke përfshirë instalimin e një objekti për larje të autobusëve. Uji që furnizon këtë objekt vjen nga dy puse uji për të cilët Kompania ka marrë Leje Shfrytëzimi nga Ministria e Mjedisit. Janë instaluar dy ujëmatës sipas rekomandimeve të Lejes së Shfrytëzimit, për të kontrolluar dhe raportuar sasinë e ujit që përdoret. Efluentët e ujërave të zeza derdhen në kanalizim nëpërmjet ndarësve të vajit dhe yndyrës. Lokacioni ka një histori kontaminimi, të lidhur me deponimin e derivateve, vajit solar (për ngrohje) dhe mbetjeve të vajrave. PVMS-ja kërkon që Kompania të zhvillojë një Plan Monitorimi dhe Raportimi (duke përfshirë monitorimin e cilësisë së efluentit).

Brenda kompleksit të Kompanisë, do të caktohet një zonë e re parkimi për të shërbyer si një objekt për mbushje për autobusët e rinj elektrikë. Kompania ka finalizuar një Plan për Gatishmëri për Emergjencë dhe Reagim. Zyrat e rinovuara rishtazi janë të pajisura me detektorë tymi dhe në ambiente janë vendosur aparate zjarrfikëse.

Politikat e Burimeve Njerëzore dhe Kushtet e Punës të Kompanisë janë në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe Kërkesën 2 të Performancës së BERZH-it ("KP2"). Janë vërejtur disa përmirësime që nga vizita e fundit për MS në terren, duke përfshirë zhvillimin e një mekanizmi formal për ankesa të punëtorëve dhe një politikë të sigurisë shëndetësore dhe sociale. Për shkak të sektorit të aktivitetit, PVMS-ja kërkon që Kompania të zhvillojë një program trajnimi të vozitësve me dispozita specifike për Dhunën dhe Ngacmimin në Baza Gjimore. Nëse Kompania duhet të zbatojë një largim kolektiv nga puna (për shkak të kalimit të propozuar në funksionimin pa bileta në planin afatgjatë), ajo do të duhet të përgatisë një plan për rivendosje, duke përfshirë trajnimin e duhur për konduktorët aktualë, siç konfirmohet në PVMS.

Plani ekzistues për Angazhim të Palëve të Interesit (PAPI) është përditësuar në përputhje me Projektin GrCF2W2 - Transporti Urban Prishtinë II. Kompania ka një linjë telefonike përmes së cilës qytetarët dhe klientët mund të kërkojnë informacion ose të paraqesin ankesat e tyre; numri i telefonit të linjës telefonike është i printuar në faturat e biletave të autobusit dhe ka një kuti për ankesa në hyrje të bazës.

Banka do të monitorojë performancën mjedisore dhe sociale të Projektit dhe zbatimin e PVMS-së duke shqyrtuar Raportet Vjetore Mjedisore dhe Sociale (RPMS).

Bashkëpunimi Teknik dhe Financimi me Grante

Para nënshkrimit

- a) **BT 1:** Kujdesi i Duhur Teknik për të vlerësuar fizibilitetin e Projektit, duke përfshirë futjen e 6 autobusëve elektrikë dhe infrastrukturës përkatëse dhe përgatitjen e specifikimeve teknike për autobusët elektrikë dhe diesel që do të prokurohen në kuadër të Projektit. Kostoja e detyrës është 74,871 EURO (E përfunduar);
- b) **BT2:** Kujdesi i Duhur Mjedisor dhe Social. Kostoja e detyrës është 39,709 EURO (E përfunduar).

Pas nënshkrimit

- c) **BT3:** Mbështetje për Zbatim të Projektit për ta mbështetur Kompaninë me përgatitjen dhe vlerësimin e tenderit, negocimin e kontratës dhe mbikëqyrjen e punimeve, duke përfshirë inspektimin para dorëzimit. Kostoja e vlerësuar e detyrës është 200,000 euro;
- d) **KT4:** Mbështetje për Komunën për ristrukturimin dhe zbatimin e rrjetit të autobusëve, duke përfshirë planifikimin me pjesëmarrje të transportit urban, futjen e rrjetit të ri të autobusëve, kontraktimin përkatës dhe monitorimin e KSHP-së. Kostoja e vlerësuar e detyrës është 450,000 euro;

Kontributet e klientit: Klienti do të jetë përgjegjës për të paguar të gjithë TVSH-në dhe tatimet e tjera indirekte që aplikohen për detyrat e BT-së pas nënshkrimit të financuara nga donatorët, ku ata janë palë kontraktuese, si një kontribut paralel i ndarjes së kostos në Projekt (TVSH-ja është 18 për qind në Kosovë). Për fundi, Klienti do të ofrojë edhe mbështetje në natyrë në formën e hapësirës së zyrës, lidhjeve të komunikimit, etj., për punën e konsulentëve, që supozohet të jetë 3 për qind e buxhetit total të BT-së.

Informatat e Kontaktit të Kompanisë

Arta Domi, Kryeshefe Ekzekutive
info@trafikurban-pr.com
+383 45 10 11 22
<https://trafikurban-pr.com/>
Tahir Zajmi nr. 43, 10000 Prishtinë, Kosovë

Përmbledhja e zbatimit

Përditësimi i fundit i DPP-së

07 dhjetor 2022

Material i lidhur

Projekti kornizë

- [Korniza: Qytetet e Gjelbra 2 - Dritarja II](#)
Publikuar më: 30.09.2020

Të Kuptuarit e Tranzicionit

Informata të mëtejshme në lidhje me qasjen e BERZH-it për matjen e ndikimit të tranzicionit janë të disponueshme [këtu](#).

Mundësitë për Biznes

Për mundësitë për biznes ose prokurimet, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH-in (jo lidhur me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: projectenquiries@ebrd.com

Për projektet e sektorit shtetëror, vizitoni [Prokurimet e BERZH-it](#):

Tel: +44 20 7338 6794
Email: procurement@ebrd.com

Pyetje të përgjithshme

Pyetjet specifike mund të bëhen duke përdorur [formularin e BERZH-it për pyetje](#).

Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

Kjo [PMS](#) dhe Kërkesat e lidhura të Performancës (KP) përcaktojnë mënyrat në të cilat BERZH-i zbaton zotimin e vet për të promovuar “zhvillimin e shëndoshë mjedisor dhe të qëndrueshëm”. PMS-ja dhe KP-të përfshijnë dispozita specifike për klientët që të respektojnë kërkesat e zbatueshme të ligjeve kombëtare për informim dhe konsultim publik, si dhe për të krijuar një mekanizëm për ankesa për të marrë dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, në veçanti, në lidhje me performancën mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në përpjesëtim me natyrën dhe shkallën e risqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale të një projekti, BERZH-i kërkon edhe që klientët e vet ta shpalosin informacionin, sipas rastit, në lidhje me risqet dhe ndikimet që rrjedhin nga projektet, ose të ndërmarrin konsultime domethënëse me palët e interesit dhe t'i marrin në konsideratë dhe t'u përgjigjen reagimeve të tyre.

Më shumë informata mbi praktikën e BERZH-it në këtë drejtim jepen në [PMS](#).

Integriteti dhe Pajtueshmëria

Zyra e Zyrarit Kryesor për Pajtueshmërisë (OCCO) të BERZH-it promovon qeverisjen e mirë dhe siguron që në të gjitha aktivitetet e Bankës të zbatohen standardet më të larta të integritetit në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare. Kujdesi i duhur për integritetin kryhet për të gjithë klientët e Bankës për të siguruar që projektet të mos paraqesin risqe të papranueshme për integritetin ose reputacionin e Bankës. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e çështjeve në fazat e miratimit të vlerësimit të projektit, është mjeti më efektiv për të garantuar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan një rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon në monitorimin e risqeve të integritetit në projektet pas investimit.

OCCO është gjithashtu përgjegjës për hetimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe sjellje të pahijshme në projektet e financuara nga BERZH-i. Çdokush, si brenda ose jashtë Bankës, që dyshon për mashtrim ose korrupsion, duhet t'i paraqesë një raport me shkrim Zyrarit Kryesor për Pajtueshmërinë me e-mail në compliance@ebrd.com. Të gjitha çështjet e raportuara do të trajtohen nga OCCO për përcjellje. Të gjitha raportet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportet mund të bëhen në çdo gjuhë të Bankës ose të vendeve ku operon Banka. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

Politika për Qasje në Informacion (PQI)

PQI-ja përcakton mënyrën se si BERZH-i e shpalos informacionin dhe konsultohet me palët e veta të interesit për të promovuar vetëdijesim dhe të kuptuar më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta, pas hyrjes në fuqi më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e [Politikës për Qasje në Informacion](#) për të kuptuar se çfarë informacioni disponohet nga ueb faqja e BERZH-it.

Kërkesat specifike për informacion mund të bëhen duke përdorur [formularin e BERZH-it për pyetje](#).

Mekanizmi i Pavarur për Llogaridhënie të Projektit (MPLLP)

Nëse përpjekjet për adresim të shqetësimeve mjedisore, sociale ose publike me Klientin ose Bankën janë të pasuksesshme (p.sh. përmes mekanizmit të ankesave në nivel të projektit të Klientit ose përmes angazhimit të drejtpërdrejtë me menaxhmentin e Bankës), individët dhe organizatat mund të kërkojnë t'i drejtojnë shqetësimet e tyre nëpërmjet Mekanizmit të Pavarur të BERZH-it për Llogaridhënie të Projektit (MPLLP).

MPLLP-ja i shqyrton në mënyrë të pavarur çështjet e Projektit që besohet se kanë shkaktuar (ose ka gjasa të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i Mekanizmit është: të mbështesë dialogun ndërmjet palëve të interesit të Projektit për t'i zgjidhur çështjet mjedisore, sociale dhe publike; të përcaktohet nëse Banka është në pajtueshmëri me [Politikën e vet Mjedisore dhe Sociale](#) ose dispozitat specifike për projektin të [Politikës së vet për Qasje në Informacion](#); dhe aty ku është e aplikueshme, të adresojë çdo papajtueshmëri ekzistuese me këto politika, duke parandaluar papajtueshmëritë e ardhshme nga ana e Bankës.

Ju lutemi vizitoni [ueb faqen e Mekanizmit të Pavarur për Llogaridhënie të Projektit](#) për të mësuar më shumë rreth MPLLP-së dhe mandatit të vet; si [të paraqisni një kërkesë](#) për shqyrtim; ose kontaktoni MPLLP-në përmes adresës e-mail ipam@ebrd.com për të marrë udhëzime dhe më shumë informacion mbi MPLLP-në dhe mënyrën e paraqitjes së një kërkesë.